



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 2118 / Prot.
3

Tiranë, më 06.09.2023

VENDIM

Nr. 80, datë 06.09.2023

PËR
MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË
NË PROGRAMET E STUDIMEVE “SHKENCAT E LËVIZJES”, “FUSHAT E
VEPRIMTARISË FIZIKE, TË SHËNDETIT DHE REKREACIONIT” DHE “SHKENCAT E
REHABILITIMIT” PËR RAUNDIN E DYTË
PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024

Mbështetur në Urdhërin e Përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, Nr.10, datë 10.07.2023 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2023-2024”, Rektorati në mbledhjen e datës 06.09.2023

VENDOSI:

1. Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore brenda datës 18-19 shtator 2023 shkarkon nga Portali U-Albania listën e aplikantëve në programet përkatëse të studimit të ciklit të parë në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes dhe Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe ia përcjell dy Njësive Kryesore dhe i afishon në mjediset e tyre dhe në Faqen Zyrtare elektronike.
2. Datat e regjistrimit të kandidatëve për konkursin e pranimit në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, janë 18-19 shtator 2023 nga ora 09:00 deri në 15:30.
3. Datat e regjistrimit të kandidatëve për konkursin e pranimit në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, janë 18-19 shtator 2023 nga ora 09:00 deri në 15:30.
- (Regjistrimi do të jetë i hapur për Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe rekreacionit deri në orën 11.00 të datës 20 shtator 2023)
4. Dokumentet që duhet të ketë kandidati për regjistrim për konkurset e pranimit do të jenë:
 - 2 fotografi dokumenti 4x6
 - Fotokopje e kartës së identitetit
 - Mandat pagesa e tarifës së konkurimit
 - Kartela mjekësore.
5. Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes dhe Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit brenda datës 19 shtator 2023 për Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes dhe brenda

datës 20 shtator 2023 për Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, shpall listat e kandidatëve të regjistruar për konkurset e pranimit.

6. Data e zhvillimit të konkursit të pranimit në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes është 20 shtator 2023 ora 09.00.
7. Data e zhvillimit të konkursit të pranimit në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit është 20 shtator 2023 ora 12.00
8. Rregulloret e konkurseve të pranimit, testet praktike, kartela mjekësore gjenden në Faqen Zyrtare të UST-së.
9. Drejtorja e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore brenda 18-19 shtator 2023 shkarkon nga Portali U-Albania listen e aplikantëve që kanë përzgjedhur programin e studimit pranë *Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit*.
10. Drejtorja e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore brenda datës 20 shtator 2023, afishon dhe publikon listën e renditjes së aplikantëve të të tre Fakulteteve, duke përdorur si element identifikues vetëm ID e tyre të maturës.
11. Drejtorja e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore në datë 21 shtator 2023, ngarkon një kopje elektronike të këtyre listave në Portalin U-Albania.
12. Regjistrimi në Raundin e II-të të kandidatëve fitues në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë në UST do të zhvillohet në datat 22 shtator – 01 tetor 2023, (5 faza 48-orëshe nga ora 08.00 – 16.30).
13. Kriteret e pranimit, kuotat e pranimit, testet e konkursit së bashku me rregulloren e përkatëse si dhe plani mësimor për ciklin e parë të studimeve, publikohen në Faqen Zyrtare të UST-së dhe Portalin U-albania.
14. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi dhe marrjen e të gjitha masave për zhvillimin e gjithë procedurave të pranimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, Administratori i UST-së, Zv/Rektorët, Dekanatet e Fakulteteve, Drejtorja e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore, Drejtorja e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët.
15. Ky vendim shpallet në Faqen Zyrtare të UST-së.
16. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof.Dr. Agron KASA

